

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SPAK hap dosjen Baks-Rrjolli/ Roli i “zonjës” së territorit Adelina Greca, vëllezërit Efthimi dhe plani që ur banizoi tokat e resorteve
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/26/spak-hap-dosjen-baks-rrjolli-rol-i-zonjes-se-territorit-adelina-greca-vellezerit-efthimi-dhe-plani-qe-urbanizoi-tokat-e-resorteve/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 17:04:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 17:00:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7afb5e986ff4b7f27a99ac943f142b3890f852209094db80581677eaa598b123
TEKSTI	0fc86354d1ca1275ccd954785160a11591a873ea79450057e0def474fc7c4f41
PAMJA	e5c6e3a6cc679511b537c887c365a1411dad9cec00d3e454d553a97a1d7e2544

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9974b3ac639adcf314151e319ad1df4eb41bf3eb7c08853d2efc7567d82441f6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f11c1668384a0114026088dd439e5bbabdb3d48a586475de97c9d12c35b4ba6b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9974b3ac639adcf314151e319ad1df4eb41bf3eb7c08853d2efc7567d82441f6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPAK hap dosjen Baks-Rrjollit/ Roli i “zonjës” së territorit Adelina Greca, vëllezërit Efthimi dhe plani që urbanizoi tokat e resorteve

Kryesore

Publikuar: 26/09/2026



Gjkata e Posaçme ka urdhëruar SPAK-un të regjistrojë procedimin për Baks-Rrjollin, pas ankesës së banorëve që pretendojnë se toka ku po ngrihet Baks Bay është përfituar përmes dokumenteve të falsifikuara. Në kallëzim përmenden Fatmir Shpellza dhe “Gener 2”, ndërsa konflikti për pronësinë tashmë ka kaluar në duart e prokurorëve të posaçëm.

Dokumenti më i fortë për tokën ndodhet në vetë dosjen zyrtare të resortit. Leja nr. 360/1, datë 15 janar 2026, i është dhënë “ABA BLUE BORG” sh.p.k. për 33 struktura akomoduese dhe shërbimi mbi 147 ha, ndërsa identifikon pesë pasuri në ZK 1076: 81/3, 73/3, 116/26, 189/5 dhe 73/7.

Faqja e dytë e lejes tregon edhe rrugën e tokës. Më 30 tetor 2024, Fatmir Shpellzaj dhe Gener 2 lidhën kontratë për zhvillimin e 1,171,946 m². Më 10 dhjetor 2024, Gener 2 ia kaloi ABA Blue Borgo-s të drejtat dhe detyrimet e investimit e ndërtimit “pa kundërshtëpërbim”. Në kontratën e 24 janarit 2025, Gener 2 shënohet si “pronari i truallit”, ndërsa ABA Blue Borgo si investitor.



Baks-Rrjollit kishte ndërkohë vite që përgatitej për zhvillimin e madh turistik.

Baks-Rrjollit kishte hyrë në makinën shtetërore të planifikimit vite përpara këtyre kontratave. Më 23 tetor 2019, Këshilli Kombëtar i Territorit miratoi nismën për hartimin e Planit të Detajuar të Zonës me Rëndësi Kombëtare. Më 28 dhjetor 2020 erdhi miratimi i planit.

Me të lexuarat

33-kateshi në Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me “grupin e kokainës” për “Kullën e

Tiranës” Ish-sherija e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiq të e saj Historia e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Elhasanit

40 miliona euro tendera / Kush është fierakja Diana Laba që vjedh paratë e bashkive me Partinë Demokratike drejt

zhvendosjes, por Liburn Ali nuk ndalon tenderat, miliona euro për godinat ...

Dokumenti i KKT-së tregon qartë edhe rolin që kishte AKPT. Kërkesa e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për miratimin e planit kaloi nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, ndërsa bashkë me vendimin u miratuan Plani i Detajuar i Zhvillimit, rregullorja dhe hartat që do të përcaktonin mënyrën si do të zhvillohej zona.

AKPT kishte në dorë kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të tjera të planifikimit me PDZRK-në e Baks-Rrjollit dhe ishte ndër institucionet e ngarkuara me zbatimin e vendimit. Planet vendore, projektet strategjike dhe zhvillimet që preknin territorin duhej të respektonin kuadrin e miratuar për zonën.

Në krye të AKPT-së qendron Adelina Greca.

Raporti i planit të zhvillimit tregon më qartë se çdo hartë se çfarë ndryshimi po përgatitej për Baks-Rrjollin. Në gjendjen ekzistuese, 70.60% e territorit klasifikohet si sistem natyror, 10.71% bujqësor dhe 10.51% sistem ujor; vetëm 7.11% ishte sistem urban. Vetë dokumenti e përshkruante zonën si një territor ku dominonin sistemet natyrore, bujqësore e ujore dhe ku zhvillimet urbane e infrastrukturore ishin të pakta.

 SPAK hap dosjen Baks-Rrjollit/ Roli i "zonjës" së

Plani pastaj përcaktoi drejtimin e ri. Për një kapacitet të parashikuar prej rreth 6 mijë pushuesish, raporti shkruante se, nisur nga karakteri natyror dhe bujqësor i Baks-Rrjollit, konvertimi në sistem urban dhe infrastrukturor ishte "i pashmangshëm". Mes konvertimeve të propozuara, kalimi nga sistem natyror në sistem urban lidhej drejtpërdrejt me ndërtimin e resorteve me 4-5 yje.

Dokumenti shkon edhe më tej te nënnyësia 6/1. Territoret aty përshkruhen si sipërfaqe të mëdha me "karakter të theksuar natyror", me potencial për t'u kthyer në resorte të një cilësie të lartë 4-5 yje. Mënyra e ndërhyrjes e caktuar nga plani ishte: Urbanizimi.

 SPAK hap dosjen Baks-Rrjollit/ Roli i "zonjës" së

Pra AKPT nuk po administronte thjesht një hartë ku diku shfaqeshin hotele. Plani që kaloi nëpër institucionin e Grecës caktoi transformimin e përdorimit të territorit, kapacitetin turistik, zonat që do të urbanizoheshin dhe resortet që do të vendoseshin mbi një hapësirë që vetë dokumenti e përshkruante si kryesisht natyrore.

Raporti evidentonte ndërkohë Lagunën e Vilunit, Malin e Rencit, tokat ligatinore, dunat ranore dhe Monumentin e Natyrës Rana e Hedhun si vlera të zonës. Mes çështjeve që kërkonin adresim përmendej edhe "mosevidentimi i zonave të ndjeshme mjedisore".

 SPAK hap dosjen Baks-Rrjollit/ Roli i "zonjës" së

Plani që Agjencia administronte kishte të shkruar edhe projektin konkret. Harta zyrtare e projekteve prioritare mban shënimin “*Studio Projektuese – Atelier 4*”, ndërsa në tabelën e planit të veprimit shënohet “*Ndërtimi i 3-4 resorteve me 4-5 yje sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.*”

 SPAK hap dosjen Baks-Rrjollit/ Roli i “zonjës” së

Atelier 4 është studioja e vëllezërve Efthimi, bashkëpunëtorë të hershëm dhe të afërt të Adelina Greca në planifikimin e territorit. Sipas informacioneve të Pamfletit, marrëdhënia Greca-Efthimi është e ngushtë dhe e konsoliduar prej vitesh. Dokumentet publike tregojnë edhe bashkëpunime të mëparshme institucionale mes AKPT-së dhe Atelier 4.

 SPAK hap dosjen Baks-Rrjollit/ Roli i “zonjës” së

Më 29 janar 2019, në forumin për strategjitë territoriale të Peqinit, **Roskovecit**, Patosit dhe Mallakastrës, procesverbali shënon konsulentët e Atelier 4 dhe tregon se takimin e hapi vetë Adelina Greca, në cilësinë e Drejtores së Përgjithshme të AKPT-së. Pas saj, prezantimin e projektit e mori drejtuesja e projektit nga Atelier 4.

Pak më vonë, e njëjta studio do të projektonte Baks-Rrjollin.

Roli i AKPT-së vazhdoi edhe pas miratimit të planit. Në vitin 2023, kur KKT ndryshoi vendimin e vitit 2020 dhe hoqi pjesën e Rana e Hedhun, propozimi erdhi nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Baks-Rrjollit mbeti në fuqi, ndërsa AKPT u ngarkua me përditësimin e dokumentacionit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

Nga miratimi i planit, kontrolli i përputhshmërisë dhe deri te ndërhyrja e vitit 2023, AKPT ka qenë brenda procesit që përcaktoi rregullat e zhvillimit të Baks-Rrjollit.

 SPAK hap dosjen Baks-Rrjollit/ Roli i “zonjës” së

Në vitin 2024 dokumentet mjedisore nxjerrin “*GENER 2*” sh.p.k. dhe “*ABA BLUE BORGO*” sh.p.k. si zhvillues të Blue Borgo, me një sipërfaqe trualli prej rreth 1.47 milionë m². Blue Borgo është projekti që sot njihet si Baks Bay.

Po atë vit, Atelier 4 u shfaq përsëri në një konkurs të madh të AKPT-së.

Agjencia organizoi “*Çift-Konkurset për Zhvillimin e Pronës Publike*”. Për G1, Loti 1 – Klasteri i Administratës Publike, fituese u shpall skuadra Coldefy et Associés | Atelier 4 | Sempervirens | AEI Progetti | Jacopo Foggini.

 SPAK hap dosjen Baks-Rrjollit/ Roli i “zonjës” së

Mes anëtarëve të jurisë ishte Adelina Greca, Elira Kokona dhe Edi Rama

Historia e Grecës në krye të Agjencisë kishte ndërkohë një precedent të rëndë me KLSH

KLSH, pas auditimit të AKPT-së, i kërkoi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të vlerësonte përgjegjësinë e A.G., Drejtore e Përgjithshme e AKPT-së, dhe të niste procedurën disiplinore me masa që shkonin nga “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga detyra”.

KLSH rendiste katër çështje: “Akademinë 100+ Fshatrat”, projektin e Shkollës së Magjistraturës, Aktin e Përputhshmërisë për PPV-në e Shkodrës dhe prokurimet e Planeve të Detyruara Vendore. A.G. ishte Adelina Greca.

Te “Akademia 100+ Fshatrat”, audituesit konstatuan 3,230,000 lekë dëm ekonomik dhe shkruanin se për 38 ekspertët e paguar nuk kishte evidencë të dokumentuar të angazhimit të tyre në projekt. KLSH kërkonte që titullari i AKPT-së të ndiqte rrugët ligjore për arkëtimin e shumës.

Ministrisë iu kërkua të niste një procedurë për largimin e Grecës nga detyra. Greca mbeti në krye të AKPT-së.

 SPAK hap dosjen Baks-Rrjollit/ Roli i “zonjës” së

Sipas informacioneve të Pamfletit, historia e saj në planifikimin e territorit ka edhe një pistë më të rëndë. Burime të redaksisë thonë se Greca ka vepruar në episode të caktuara edhe për llogari të interesave të një grupi mafioz, duke përdorur pozicionin dhe ndikimin e saj në proceset e planifikimit.

Dosja që është hapur sot ka dokumentet e veta. Leja e Blue Borgo/Baks Bay jep emrat, kontratat dhe sipërfaqet: Fatmir Shpellzaj, Gener 2, ABA Blue Borgo, 1,171,946 m² në kontratën e zhvillimit dhe kalimin e të drejtave të investimit të kompania e resortit pa kundërshpërblim.

Përpara kësaj, plani që kaloi nëpër AKPT e kishte përshkruar Baks-Rrjollin si territor të dominuar nga natyra, bujqësia dhe uji, kishte quajtur të “pashmangshëm” urbanizimin e tij për zhvillimin turistik dhe kishte vendosur në letër resortet 4-5 yje. Studioja që e projektoi ishte Atelier 4 e vëllezërve Efthimi. /**Pamfleti**

TAG:

Adelina Greca

Fatmir shpellzaj

Spak

Të ngjashme





Katër anëtarë të familjes shqiptare u shuan në Athinë! Florinda dhe bashkëshorti ishin në muaj mjalti, vëllai i saj dhe kunata po prisnin një fëmijë



33-katëshi në Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me “grupin e kokainës” për “Kullën e Tiranës”

40 milionë euro tendera / Kush është fierakja Diana Laba që vjedh paratë e bashkive me punime fiktive përmes kompanisë Colombo, skema dhe emrat

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.